

## **Institut i ri për sociologji**

**Prof. Hamit BEQJA, akademik**

(Botuar në “Tirana Observer”, datë 16 dhjetor 2006)

Më kanë bërë nder që më kanë zgjedhur Kryetar Nderi të Institutit të ri të Sociologjisë.

\* \* \*

Deri tani nuk ka patur institucion të veçantë për sociologji. As specialistë të mirëfilltë të kësaj fushe. Problem që kohët e fundit është kapur fort. Nga ata që në mënyrë të përafërt janë marrë disi me këtë punë.

\* \* \*

Në këtë veprimtari është dalluar Lekë Sokoli, duke hedhur idenë e formimit të një institucioni të specializuar, duke marrë nismën e organizimit të një kuvendi dhe duke tërhequr në të edhe kolegë të tjerë me një minimum bagazhi e përvoja, duke më përfshirë edhe mua, pak a shumë i njohur, po them, si sociolog.

\* \* \*

Kuvendi u zhvillua këto ditë, në nëntorin që sapo kaloi. Këtë kuvend e kam përshëndetur me mesazhin që vijon: “Në rrethana të papërshtatshme fizike për të qenë sot bashkë me ju në këtë akt themelues ju përshëndes me gjithçka kam të mundshme, me mendje e me zemër..”. Me një mesazh të veçantë kam vlerësuar lart punën e palodhur dhe ndihmesën e çmuar në fushën e sociologjisë të Lekë Sokolit, përkushtimin tërësor të tij për të arritur nëpërmjet një vargu masash të përshkallëzuara, deri në ditën e këtij promovimi serioz e dinjitoz.

\* \* \*

E ndjej të nevojshme të them, se deri tani i jam kushtuar kësaj fushe në mënyrë të përafërt. I tillë është edhe zotimi im në themelimin e kësaj qendre studimore sociale, për fushën e së cilës është folur jo pak, por pa patur shumë punime të veçanta. As në shkencat albanologjike të Akademisë së Shkencave, as në fakultetet humanitare të universiteteve tona. Por, duke mos qënë partizan i personalizimit, jo për modesti, dhe as për të ngelur “në hije” mendoj se këtë radhë ky përjashtim që po bëj e forcon rregullin.

\* \* \*

I ndërftuar në sociologji si specialist i ardhur nga psikologjia e pedagogjia jam marrë pak a shumë me psikologji e pedagogji sociale. Këtë është edhe ndihmesa ime që duket në kumtesa të veçanta, në librin “Rrjedhave të sociologjisë dhe të edukatës” dhe në librin “Divorci” (bashkautor me Lekë Sokolin).

Në fundin e viteve '80-të u shtrua problemi i organizimit të studimeve sociologjike dhe i përgatitjes së kuadrit për këtë fushë, fillimisht, qoftë edhe nëpërmjet studimeve pasuniversitare. Por, në këtë mes pati edhe kundërshtime të diktuar nga pikëpamjet moniste të kohës. Sipas tyre nuk kishte shkencë të sociologjisë. Këtë detyrë e kryente materializmi historik, prandaj shkonte puna deri atje sa marrja me sociologji të mirëfilltë konsiderohej tabu.

Me kalimin nga monizmi njëpartiak në pluralizmin demokratik u hap rruga për kapërcimin e përshkallëzuar të kësaj tabuje. U ndërmorën hapat e masat e para, por për të qenë objektiv duhet pranuar se nuk është bërë kushedi se çfarë.

Krijimi i institutit të ri synon ta kapërcejë këtë gjendje. Kuptohet, duke e organizuar këtë punë mbi baza demokratike, duke respektuar mendimin e lirë, mendimin ndryshe dhe duke aktivizuar, jo vetëm ata që mund të quhen sociologë të mirëfilltë, por edhe specialistë të fushave të ndryshme të përafërta me sociologjinë.

Kështu, para nesh hapet një fushë e gjerë veprimtarie, të cilës duhet t'i përkushtohemi me seriozitet, me kompetence dhe me të gjitha energjitë.

**Me urimet më të mira!**